

KONSERVATORI DHE SHKOLLA E MESME JAN DEYL, institucion i financuar nga shteti  
Pragë 1 – Malá Strana, Sheshi Maltezské náměstí 14, Kodi postar 118 44



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

e lidhur sipas nenit 1746, paragrafi 2 i Ligjit nr. 89/2012, Kodi Civil i Republikës Çeke

**Konservatori dhe Shkolla e Mesme Jan Deyl, institucion i financuar nga shteti**


Numri unik identifikues: 613 87 339, numri i TVSH-së: CZ61387339

me seli në Maltezské náměstí 476/14, 118 00 Praga 1

i përsaqësuar  drejtoreshë

të dhënët bankare:

Banka Kombëtare Çeke



Adresa e mbajtësit të llogarisë bankare: Maltezské náměstí 476/14,  
118 00 Praga 1

(më tej në tekst si "organizatë")

**QBMK Xheladin Deda Pejë, Kosovë**

Numri unik identifikues: 602945836

me seli në: Pejë, ruga Bill Clinton, nr 183



(më tej në tekst si "pjesëmarrës")

(Organizata dbe Pjesëmarrësi, së bashku në tekstin e mëtejshmë si "palët kontraktuese" ose individualisht si "pala kontraktuese")

Lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi në ditën, muajin dhe vitin e specifikuar më poshtë  
(në tekstin e mëtejshmë si "marrëveshje").

### I. Parathënie

- Organizata është partnerë e projektit - Aplikimi i njohurive çake në fushën e kujdesit për fëmijët e verbër dhe fëmijët me afërsi të kufizuara të kombinuara (në tekstin e mëtejshmë "projekti").
- Pjesëmarrësi është i interesuar të krijojë bashkëpunim me Organizatën dhe të marrë pjesë në projekt në periudhën nga 1 qershor deri më 31 tetor 2025.

3. Pēr tē qenē nē gjendje tē marrē pjesē nē projekt, Pjesēmarrēsi synon tī ofrojē Organizatēs kompensim pēr kostot qē liddon me projektin, nē masēn dhe sipas kushtev tē pēreaktuara nē kētē marrēveshje.

## II. Lenda e Marrēveshjes

4. Objekti i kësaj marrēveshjeje ēshti regullimi i bashkēpunimit midis Organizatēs dhe Pjesēmarrēsit, duke pērshirō angazhimin e Pjesēmarrēsit nē projekt.
5. Si pjesē e bashkēpunimit me pjesēmarrēsin liddur me angazhimin e tij nē Projekt, organizatēs do tīl sigurojē materiale nē vlerē prej 500 euro, konkretisht:
- Letēr pēr printer,
  - Letēr Braille,
  - Tonerē pēr printer,
  - Materiale pēr lidiżżeen e dokumenteve
- (nē tekstin e mōtejmē si “**materiali i ofruar**”).
6. Pērveç materialit tē ofruar, Organizata do tē ofrojē, si pjesē e bashkēpunimit me Pjesēmarrēsin gjatē angazhimit nē projekt:
- trajnim nē fushēn e kujdesit pēr fēmijet e verbōr dhe fēmijet me astēsi tē kuċzuara tē kombinuara me vlerē 1,450 euro,
  - sherbime tē njē edukatori special me vlerē 1,200 euro
- (nē tekstin e mōtejmē si “**sherbimet e ofruara**”).
7. Nē lidiżżeen me pjesēmarrējen nē projekt, Pjesēmarrēsi merr pērsipēr tī ofrojē Organizatēs kompensim pēr kostot e liddura me projektin, gjegjēsish tē pēr materialin e ofruar dhe sherbimet e ofruara, nē mēnyrōn dhe sipas kushtev tē pēreaktuara nē nerin, III tē kësaj marrēveshje.
8. Organizata merr pērsipēr tē merr pērsipēr shpenzimet qē lidiżżeen me projektin, gjegjēsish transportin, akomodimin dhe ushqimin pēr pjesēmarrēsit nē projekt.

## III. Rimbursimi i shpenzimeve dhe kushtet e pagesēs

1. Rimbursimi i shpenzimeve pēr materialin dhe sherbimet e ofruara nē kuadēr tē bashkēpunimit me Pjesēmarrēsin gjatē angazhimit nē projekt. Əshtē 3,150 euro (nē tekstin e mōtejmē “**rimbursimi i shpenzimeve**”).
2. Pjesēmarrēsi do ta realizoj pagesēn pēr rimbursimini e shpenzimeve pērmes transferit bankar nē llogarinē bankare tē Organizatēs tē spċifikuar nē krye tē kësaj marrēveshjeje deri mē 31 tetor 2025.
3. Pēr qellimet e kësaj marrēveshjeje, pagesu e rimbursimi tē shpenzimeve do tē konsiderohet si e pērfunduar nē datēn e kreditimit tē shumōs pērkatħse nga llogaria bankare e Pjesēmarrēsit nē llogarinē bankare tē Organizatēs.

#### IV. Detyrimet e palëve kontraktuese

- Palët kontraktuese janë të detyruara të veprojnë me kujdesin e duhar në përbushjen e detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kjo marrëveshje në përputhje me dispozitat ligjore.
- Palët kontraktuese zotohen t'i ofrojnë njëra-tjetrës bashkëpunim dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për të siguruar përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje në masën që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga palët kontraktuese.
- Palët kontraktuese marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me faktet dhe informacionet konsidenciale dhe të klasifikuara, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë dhe rrethanat e palës tjetër kontraktuese, të cilat i kanë kuptuar gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, të cilat informacione, në rast se zbulohen, do të mund t'i shkaktojnë dëme palës tjetër kontraktuese.
- Palët kontraktuese marrin përsipër të vazhdojnë me përpunimin e të dhënave personale të transmetuara në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla (GDPR). Palët kontraktuese janë në veçanti të detyruara të përpunojnë këto të dhëna personale ekskluzivisht për qëllimet e përbushjes së kësaj marrëveshje vetëm për periudhën e nevojshme dhe nuk kanë të drejtë t'a transferojnë këto të dhëna personale një pale të tretë, përvëç tështë që detyrim i përcaktuar nga dispozitat ligjore ose tështë i nevojshëm për përbushjen e marrëveshjes.
- Palët bien dakord që asnjëra palë nuk do t'a transferojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrin të palës tjetër.

#### V. Kohëzgjatja dhe përfundimi i marrëveshjes

- Kjo marrëveshje lidhet përmes një afat të caktuar deri më 31 tetor 2025.
- Kjo marrëveshje mund të përfundojë:
  - me marrëveshje me shkrim të palëve kontraktuese,
  - me tërheqje nga kjo marrëveshje nga njëra prej palëve kontraktuese sipas kushteve të përcaktuara në dispozitat përkatëse të Kodit Civil,
- Organizata ka të drejtë të tërhoqet nga kjo marrëveshje, veçanërisht nëse Pjesëmarrësi shkel detyrimet e tij të specifikuara në nenin IV, të kësaj marrëveshjeje.
- Me tërhoqjen nga marrëveshja, kjo marrëveshje do të anulohet me efekt nga data në të cilën njostimi me shkrim përtërheqje nga marrëveshja i është dorëzuar palës tjetër kontraktuese.

#### VI. Dispozita të përfundimitare

- Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.
- Palët kontraktuese bien dakord që kjo marrëveshje do të publikohet në regjistrin e kontratave në përputhje me Ligjin Nr. 340/2015, mbi kushtet e veçanta për hyrjen në fuqi të kontratave të

KONSERVATORI DHE SHKOLLA E MESME JAN DEYL, institucion i financuar nga shteti  
Pragë 1 – Malá Strana, Sheshi Maltézské náměstí 14, Kodi postar 118 44



caktuara, publikimin e kontratave të tilla dhe në regjistrin e kontratave (Ligji mbi regjistrin e kontratave). Organizata do të sigurojë publikimin e kësaj marrëveshjeje në regjistrin e marrëveshjeve.

3. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje dhe që nuk rregullohen shprehimisht në këtë marrëveshje rregullohen me ligjet e Republikës Çeke, në veçanti nga dispozitat përkatëse të Kodit Civil.
4. Palët kontraktuese bien dakord që çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo marrëveshje do të zgjidhet kryesisht nëpërmjet negociatave dhe gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje midis palëve kontraktuese, atëherë shkalla e parë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ligjore do të jetë gjykata e përgjithshme e Republikës Çeke me juridiksim territorial sipas selisë ku është regjistruar Organizata.
5. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet vetëm me shkrim me anekse me numër rendor.
6. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje rezulton e pavlefshme ose joefektive, palët kontraktuese janë të detyruara të përfundojnë një ndryshim në marrëveshje në mënyrë që dispozita e pavlefshme ose joefektive e kësaj marrëveshjeje të zëvendësohet me një dispozitë që është sa më afërt përbajtjes me dispozitën që u gjet e pavlefshme ose joefektive. Në rast se e gjithë marrëveshja rezulton e pavlefshme ose joefektive, Palët marrin përsipër të lidhin një marrëveshje të re, përbajtja e së cilës do të jetë sa më e afërt me këtë marrëveshje.
7. Kjo marrëveshje është përgatitur në dy (2) kopje, nga një kopje për secilën palë kontraktuese.
8. Palët kontraktuese deklarojnë se e kanë lexuar këtë marrëveshje me kujdes, e kanë kuptuar përbajtjen e saj dhe nuk kanë asnjë vërejtje në lidhje me të. Ata deklarojnë më tej se nuk e kanë lidhur këtë marrëveshje nën presion në kushte dukshëm të pafavorshme dhe se kjo marrëveshje është një manifestim i vullnetit të tyre të lirë, dhe në provë të kësaj, palët kontraktuese bashkëngjitin nënshkrimet e tyre.

Në Pragë më 1 qershor 2025

Organizata



Konservatori dhe Shkolla e Mesme Jan Deyl,  
institucion i financuar nga shteti


drejtoreshë

Në Pejë me 27.05.2025

Pjesëmarrësi



QBMK Xheladin Deda, Pejë, Kosovë  
e përfaqësuar nga:



KONZERVATOŘ A STŘEDNÍ ŠKOLA  
JANA DEYLA,  
příspěvková organizace  
Maltézské náměstí 14  
118 44 Praha 1 - Malá Strana

KONSERVATORI DHE SHIKOLLA E MESME JAN DEYL, institucion i finansuar nga shtet  
Pragë 1 - Malá Strana, Sheshi Maltézské náměstí 14, Kodi postar 118 44



### PŘEKLADATELSKÁ DOLOŽKA (CZE) - KLAUZOLA E PËRKTHYESIT (ALB)

Já, [REDACTED] soudní tlumočník a překladatel jazyka českého a jazyka albánského oprávněný Krajským soudem v Prášině (rozhodnutí ze dne 17. 01. 2006, čj.: 7/2006) a zapsaný v seznamu tlumočníků a překladatelů vedený Soudeovskou radu republiky Kosova (rozhodnutí ze dne 31.07.2023), tímto stvrzuji, že jsem osobně provedl překlad připojené listiny, a že tento překlad souhlasí s textem původní listiny. Při provádění překladu nebyl přibrán konzultant.

Unë, [REDACTED] përkthyes dhe interpret gjyqësor i gjuhës çekë dhe gjuhës shqipe i lizencuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë (me vendim të datës 17.01.2006, nr. 7/2006) është i regjistruar në listën e përkthyesve dhe interpreteve gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, konfirmoj se dokumentin e bushkangjitur e kam përkthyer personalisht, dhe se ky përkthim është identik me tekstin e dokumentit në fjalë. Lidhur me përkthimin në fjalë nuk është angazhuar ndonjë konsulent/ekspert.

Tento úkon je zapsán v evidenci úkonů pod číslem položky / Ky veprām është regfistruar në regjistrin e përkthimeve me numër rendor: 2025-071

V Prištinë dne / Në Pristinë me datën 26.05.2025

